

■ Një e ardhme për të kaluarën e Prishtinës



1 mars 2006
Prishtinë

‘Prishtina është një qytet i bukur e modern me tipare të trashëguara nga kultura antike: ilire, bizantine dhe osmane. Sapo ta zbuloni Prishtinën, ju do te vëreni menjëherë sharmin dhe bukurinë e saj, dhe do te dashuroheni në Prishtinën e bukur’

www.giskos.com/visitprishtina (2006)



‘Ekipet vullnetare që shkatërrojnë qytetin e vjetër, për çdo orë pune bëjnë pesëmbëdhjetë minuta valle kombëtare’

Qytetar i Prishtinës (2005)

‘Ta shkatërrojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë’

Që nga viti 1945, tregimi për Prishtinën e vjetër është një tregim për shkatërrimin e qytetit dhe mundësive të humbura.

Në epokën e hershme komuniste, ky shkatërrim i së kaluarës ka qenë rezultat i politikave joliberalë. Motoja e ‘zhvillimit urban’ në vitin 1950 ishte ‘ta shkatërrojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë’. Siç ceket me krenari në një libër të vitit 1959:

‘Deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Prishtina ka qenë qytet tipik oriental. Pas çlirimit Prishtina përjetoj zhvillim të shpejtë për çdo lëvdatë dhe dita ditës po zhvillohet në një qytet modern. Dyqanet dhe strukturat e vjetra të paqëndrueshme shumë shpejtë janë duke u zhdukur, për ti lënë vend ndërtimit të objekteve të larta të stilit modern’

Prishtina (1959)



Në zemër të qytetit të vjetër ka ekzistuar çarshia me më shumë se 300 dyqane.

‘Sot Prishtina po i braktisë kujtimet e vjetra dhe po i largohet së kaluarës për tu bërë një qytet modern – një qytet i ri socialist.’

Prishtina (1965)

‘Strukturat e vjetra të paqëndrueshme’ që u demoluan pas luftës përfshinë: njërin prej çarshive më të mëdha të mbuluara në regjion; qendrën shpirtërore të qytetit, ku hynë xhamia, kisha kryesore katolike dhe sinagoga; hamamin e vjetër otoman; si dhe një numër i madh të shtëpive të stilit osman.

Qyteti u rrit shpejt, duke tërhequr mijëra migrues. Por për dallim prej qyteteve të tjera të Evropës (përfshirë, për shembull, Sarajevën apo Shkupin) nuk u bë asnjë përpjekje për ta ruajtur qendrën historike të Prishtinës, e cila për shekuj me rradhë e bëri këtë qytet një ndër më të rëndësishëmit në regjion.



‘Ne kemi trashëguar një qytet pa identitet’

Zyrtar kosovar, (Janar, 2006)



◀Kisha Katolike (përballë Hotel Grandit, sot qendër tregtare)

▼Rruga Nëna Terezë



▼Xhamia e Llukaqit (sot, Hotel Iliria)



‘Në këtë qytet pa lum
si i huaj rri,
i hakmirrem kohës me një gotë raki,
mendoj në ty’

‘Hero i qytetit pa lum’, Gjurmët

Qyteti pa lum

Qyteti i vjetër i Prishtinës shtrihet në mes të dy lumenjëve: Vellusha dhe Prishtina (Prishevka). Në vitet e 1950-ta lumi Vellusha, i cili rrjedhte nga kodrat e Gërmisë, u mbulua. Në fund të viteve të 1970-ta, gjithashtu u mbulua edhe lumi Prishtina, që rrjedhte nga perëndimi i qendrës së vjetër të qytetit. Këta lumenj u shndërruan në sistem të kanalizimit. Si rezultat i këtyre veprimeve, gjeografia natyrore e qytetit të vjetër mbeti e fshehur. Në vitet e 1980-ta, Prishtina u shndërrua në qytet pa lumenj dhe qytet pa një histori të dukshme.



‘Trashëgimia arkitektonike paraqet një pasqyrim të pazëvendësueshëm të pasurisë dhe llojlojshmërisë së trashëgimisë kulturore Evropiane’

Konventa e Granadës (1985)

Standardet evropiane

Në tetor të vitit 1985, ministrat evropian u mbledhën në qytetin e Granadës ku e miratuan një rezolutë që apelonte për një ‘proces të konservimit aktiv’ të trashëgimisë kulturore të Evropës. Ata theksuan se:

‘secili vend është përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore brenda territorit të vet. Cilado qoftë origjina historike, kulturore apo kombëtare e saj, konservimi i kësaj trashëgimie është *çështje e rëndësisë së përgjithshme Evropiane.*’

Nënshkruesit e Konventës u angazhuan për: mbrojtjen e trashëgimisë së tyre kulturore; mirëmbajen e inventarit që liston objektet dhe vendet që duhet mbrojtur; si dhe që revitalizimi i qyteteve dhe zonave të vjetra historike të jenë prioritet gjatë planifikimit urban.

Përfundimet që dolën nga takimi i Granadës gjithashtu theksojnë rëndësinë e ‘zgjerimit të kategorive të pasurive që duhet mbrojtur, duke përfshirë edhe shembuj të arkitekturës vernakulare, rurale, teknike, industriale si dhe të arkitekturës së shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë.’ Ata theksojnë se ‘konservimi dhe përmirësimi i trashëgimisë kulturore duhet të bazohet në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve’. Egziston një qëndrim i qartë se trashëgimia e Evropës mund të mbijetojë vetëm nëse vlerësohet nga populli në tërësi.

Gjatë viteve, pakoja e rregulloreve dhe konventave Evropiane – përfshirë këtu Kartën e trashëgimisë arkitektonike (1975), Konventën e Granadës (1985), Konventën evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike (1992) dhe Konventën për peisazhe (2000) – kanë rezultuar në një tërësi koherente dhe të detajizuar të zotimeve dhe standardeve për trashëgiminë kulturore. Këto duhen të jenë standardet përmes së cilave bota e jashtme dhe qytetarët e Kosovës do ta vlerësojnë funksionimin e institucioneve të Kosovës.

Ligji në fuqi

Në vitin 1977, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës miratoi ‘Ligjin për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës.’

Ligji thekson rëndësinë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ai e bën të qartë se përgjegjësia primare është e Institutit për mbrojtjen e monumenteve (neni 4). Instituti duhet të ‘merr masa për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës’ duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e një regjistri (neni 27). Ligji thekson se për çfarëdo veprimi mbi monumentet kulturore apo rrethinën e tyre të afërt duhet të kërkohet leje nga Instituti (neni 11).

Në këtë ligj ndëshkimet janë të definuara qartë. Neni 32 shënon së ‘Enti suprimohet nëse nuk e kryen veprimtarinë për të cilën është themeluar’. Neni 97 thekson se ‘ai që e dëmton apo shkatërron përmendoren e kulturës do të dënohet me gjobë ose me burgim për një vit’.

Ligji i vitit 1977 nuk është ligj diskriminues, edhe pse nuk është në përputhje me kriteret e sotme evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Poashtu, ky nuk është ligj i epokës së Millosheviqit. Deri më tani nuk është miratuar asnjë ligj tjetër që do ta zëvendësonte ligjin e 1977-ës. Kjo do të thotë se ky është ligji në fuqi sot, siç ka qenë edhe gjatë gjashtë viteve të fundit.



Muri perëndimor i Hamamit të madh – drunjtë e rrënjësuar në mur ilustronë moskujdesin shumë-vjeçar.

Lista e Kosovës

Në Kosovë janë 426 monumente të mbrojtura. Kjo listë nuk përfaqëson *tërë* trashëgiminë Kosovare.

Kisha ortodokse dhe gërmadha të kishave	106
Monumente arkeologjike	96
Vendbanime	42
Kulla (shtëpi tradicionale nga guri)	28
Manastire ortodokse dhe gërmadha të tyre	23
Xhami dhe gërmadha të xhamive	23
Monumente historike	22*
Veshmbathje, libra, objekte të tjera	19
Varreza	16
Teqe dhe mauzole myslimane	10
Ikona/ikonografi ortodokse	7
Ura	7
Hamame	6
Shadërvane	4
Kisha katolike	3
Çarshi	3
Sahatkulla	2
Mullinjë	2
Grup objektësh	1
Të tjera	6
TOTALI	426

*ndërtesa e fundit historike e kësaj liste është shtuar në vitin 2003.

Në qytetin e Prishtinës janë 21 monumente të mbrojtura. Shih listën complete në faqen tjetër.



Lista e qytetit të Prishtinës

Gjatë muajtve të fundit, IKS-i dhe ESI-i janë përpjekur t'i vizitojnë 21 ndërtesat e mbrojtura të qytetit të Prishtinës dhe ta vlerësojë gjendjen e tyre të tanishme. Kjo përpjekje nuk ishte e lehtë. Pikësëpari, lista e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dallon nga ajo e Institutit të Prishtinës. Së dyti, adresat në listë nuk korrespondojnë me emrat e sotëm të rrugëve, ndërsa disa nga monumentet e listuara janë zhdukur plotësisht – vetëm emrat e tyre në listë na përkujtojnë egzistimin e tyre të dikurshëm.

1. Xhamia e Mbretit
2. Xhamia e Pirinazit
3. Xhamia e Çarshisë
4. Xhamia e Jashar Pashës
5. Ikonostasi i skalitur në kishën e Shën Nikolës
6. Dy ndërtesa të arqipeshkëvisë
7. Sahat kulla
8. Shadërvani
9. Varret e hebrenjëve
10. Hamami i madh
11. Lokaliteti arkeologjik 'Tjerrtorja'
12. Mbeturinat e themeleve të hamamit të vjetër
13. Muzeu i Kosovës
14. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës
15. Shtëpi banimi/Rr. UÇK 66
16. Kompleksi i Emin Gjikut
17. Shtëpia e Hynylereve
18. Shtëpi banimi/Rr. Tanashko Raiq 7 (sot rr. Gustav Mayer)
19. Biblioteka Hivzi Sylejmani/Rr. UÇK 10
20. Shtëpi banimi/Rr. M. Popoviq (sot rr. Nazmi Gafurri)
21. Përmbledhje e dorëshkrimeve të librave të bibliotekës së Bashkësisë Islame

Në mënyrë që të vlerësohet situata aktuale, më së miri është që të shikohet secili monument individualisht.



Xhamia e Mbretit (Xhamia e Sulltan Mehmet II al-Fatih-ut, me vendim prej vitit 1953)

Kjo xhami u ndërtua në vitet 1460-1461 nga Sulltan Mehmeti II al-Fatih-u – *Pushtuesi*, vetëm tetë vite pas rënies së Konstantinopolit. Kjo është xhamia e vetme e ndërtuar nga ky sulltan që ka mbijetuar në Ballkan. Ajo gjendet në zemër të qendrës së qytetit të vjetër, dhe është xhamia më e madhe dhe më spikatur e Prishtinës. Kupola e saj ka qenë dikur më e madhja në regjion. Sheshi përpara Xhamisë së Mbretit gjithmonë ka qenë vend i njohur për takime. Gjatë viteve 1682-83, nën sundimin e Sulltan Mehmetit IV, xhamia është restauruar, ndërsa minarja e saj është riparuar përsëri pas tërmetit të vitit 1955. Kjo xhami ka vuajtur nga shkatërrimi dhe punët joprofesionale në restaurimin e saj; infrastruktura e dobët në rrethinë krijon lagështi në muret dhe shkatërron gurët e saj.



Xhamia e Pirinazit (me vendim prej vitit 1967)

Xhamia e Pirinazit u ndërtua nga të njëjtit gurë sikurse edhe Xhamia e Mbretit (Fatih). Ajo u ndërtua rreth njëqind vjet më pas, në pjesën e dytë të shekullit të XVI. Themeluesi i saj, njeriu i quajtur Piri Nazir, ka shërbyer si Vezir gjatë sundimit të dy Sulltanëve Osmanë. Sipas disa legjendave vendore ‘Guri i Llazarit’, i cili gjendet në kopshtin e xhamisë, është guri mbi të cilin Princ Llazarit i’u ka prerë koka më 1389. Para se trupi i tij të zhvendosej në Manastirin e Ravaniqit, Princ Llazari ishte i varrosur në Xhaminë e Pirinazit me lejen e Sulltan Bajazidit.



Xhamia e Çarshisë (me vendim prej vitit 1967)

Xhamia e Çarshisë shënon fillimin e qendrës së qytetit të vjetër. Ajo u ndërtua në fillim të shekullit të XV nga Sulltan Bajazidi me qëllim të përkujtimit të fitores së forcave osmane në vitin 1389. Kjo xhami është ndërtesa më e vjetër ekzistuese në Prishtinë sot.

Në të kaluarën Xhamia e Çarshisë gjendej përballë çarshisë së mbuluar të Prishtinës. Sot nuk ka mbetur asgjë nga çarshia e vjetër, vetëm emri i Xhamisë së Çarshisë shërben për të na e përkujtuar atë. Shumë ndryshime si dhe punime për riparimin e saj e kanë ndryshuar pamjen origjinale të kësaj xhamie, mirëpo simboli i saj – kulmi i gurët minares – ka mbijetuar për më shumë se 600 vite. Këtë xhami e quajnë edhe ‘Tash Xhamia’, që në përkthim do të thotë ‘Xhamia e gurit’.



Xhamia e Jashar Pashës (me vendim prej vitit 1967)

Jashar Mehmet Pasha ka qenë qytetar i pasur i Prishtinës dhe guvernator i Shkupit në vitin 1842. Sipas mbishkrimeve që gjenden brenda xhamisë, ajo u ndërtua në vitin 1834. Porta origjinale është shkatërruar për t’i lëshuar vend zgjerimit të rrugës Nazim Gafurri. Në përgjithësi, ndërtesa është në rrezik të dëmtohet nga lagështia që hyn nga çarjet e ndryshme në murre.



Ikonostasi në kishën e Shën Nikolës, dhe dy shtëpi të arqipeshkëvisë (me vendim prej vitit 1967)

Gjatë viteve të fundit, kisha e Shën Nikolës ka qenë kisha e vetme ortodokse në Prishtinë. U ndërtua në shekullin e XIX, siç duket nga ana e gurëpunuesëve nga Maqedonia perëndimore. Pjesa më e rëndësishme e kishës ka qenë ikonostasi i skalitur më 1840, dhe i futur nën mbrojtje me ligj. Gjatë trazirave të marsit 2004, kisha është djegur nga turmat e mllefosura. Një kulm i përkohshëm është ndërtuar mbi të, në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i mëtutjeshëm i mureve dhe i vizatimeve të mbetura. Ndërtesat në afërsi të kishës janë pronë e Muzeut të Kosovës, ndërsa sot aty gjendet Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.



Sahat kulla (me vendim prej vitit 1967)

Sahat kulla u ndërtua në shekullin e XIX. Pas një zjarri ajo u rindërtua me tulla. Zijla origjinale u soll nga Moldavia dhe mbante mbishkrimin: 'Kjo zile është punuar më 1764 për Jon Moldova Rumenin'. Në vitin 2001, zijla është vjedhur. Në të njëjtin vit, trupat e KFOR-it francez kanë ndërruar mekanizmin e vjetër të orës me një mekanizem elektrik. Duke marrë parasysh problemet që Kosova ka me rrymë, Sahat kulla ka vështërsi për ta treguar kohën e saktë.



Shadërvani (me vendim prej vitit 1967)

Ky shadërvan nga mermeri i dekoruar gjendet midis Xhamisë së Çarshisë dhe Muzeut të Kosovës. Ai është shadërvani i vetëm publik i llojit të vet në Prishtinë, i cili ka mbijetuar deri më sot. Në të kaluarën dhjetëra shadërvanë të tillë publik, të shpërndarë nëpër tërë qytetin të vjetër, ofronin freskim dhe mundësi për avdes (larje rituale)



Varrezat e hebrenjëve (me vendim prej vitit 1967)

Varrezat e hebrenjëve gjenden në majë të kodrës së Tauk Bashqës. Datojnë nga shekulli i XIX. Atëbotë, në Prishtinë jetonin rreth 1.500 hebrenjë. Varrezat janë futur nën mbrojtje qysh nga viti 1967, me të gjetur 57 gurë varresh. Sot varrezat janë në gjendje të mjerueshme. Të rrethuar me rrethojë metali, gurët e varrezave gjenden të fshehur pas shkurreve dhe therrave.



Mbeturinat e themeleve të Hamamit të vjetër (me vendim prej vitit 1959)

Sot nuk ka mbetur më asgjë nga Hamami i vjetër – ai u zhduk gjatë valëve të njëpasnjëshme të renovimeve urbane. Dikur ai gjendej pranë Xhamisë së Çarshisë. Gërmadhat e tij u zbuluan gjatë ndërtimit të objektit të sotëm të Qeverisë, dhe janë konsideruar si shembuj të rëndësishëm të arkitekturës së hershme urbane osmane. Megjithatë, pa u kryer hulumtimet e duhura, këto themele u mbuluan me shpejtësi nga planifikuesit e mëhershëm urban.



Hamami i madh (me vendim prej vitit 1985)

Hamami i madh i Prishtinës daton që nga shekulli i XV. Dikur ishte pjesë themelore e kompleksit të Xhamisë së Mbretit (Fatih) dhe ka shërbyer si vendtakim shoqëror si për meshkujt ashtu dhe për femrat e qytetit. Sipas legjendës, Sulltan Mehmet al-Fatih u ka urdhëruar që të gjithë punëtorët, të cilët kanë punuar në ndërtimin e Xhamisë Fatih, të lahen në Hamam për çdo ditë. Pas një zjarri më 1994, regjimi i kaluar lejoi ndërtimin e tri shitoreve, të cilat faktikisht e mbyllën hyrjen e vjetër të tij. Sot, Hamami ka nevojë për mbrojtje urgjente, sepse ujra të zeza kalojnë brenda ndërtesës ndërsa muret e saja janë më se të dëmtuara.



Lokaliteti arkeologjik 'Tjerrtorja' (me vendim prej vitit 1955)

'Tjerrtorja' ka qenë vendbanim nga koha e neolitit që gjendet në dalje të Prishtinës. Ky lokalitet arkeologjik është gjetur gjatë ndërtimit të ndërmarjës së parë shoqërore në Prishtinë - tjerrëtorës. Gjurmimet arkeologjike u ndërpreën pas ndërtimit të fabrikës, kështuqë ky lokalitet arkeologjik nuk është zbuluar në tërësi.



Muzeu i Kosovës (me vendim prej vitit 1967)


Kjo ndërtesë e stilit austro-hungarez, fillimisht u ndërtua për administratën regionale të vilajetit të Kosovës. Prej vitit 1945 deri në vitin 1975, kjo ndërtesë shërbeu si bazë e Armatës popullore jugosllave. Në vitin 1963, iu shiti Muzeut të Kosovës, ndërsa prej vitit 1999 deri në vitin 2002, ishte zyra kryesore e Agjencionit Evropian për Rindërtim. Muzeu i Kosovës ka një koleksion të gjërë të artefakteve arkeologjike dhe etnologjike. Në 1998, më shumë se 1.247 artefakte u dërguan në Beograd për një ekspozitë. Muzeu ende është duke pritur kthimin e tyre.





Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës (me vendim prej vitit 1957)

Ndërtesa e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve gjendet në shtëpinë e dikurshme të familjës Koçadishi. Pas nacionalizimit të pronës së tyre, kjo familje emigroi në Turqi. Në vitin 1954 ndërtesa i është dhënë Institutit të sapoformuar për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Kosovë.



Rruga 'UÇK', Nr. 66 (me vendim prej vitit 1967)

Ndërtesa e vjetër që ka qenë nën mbrojtje është shkatërruar pa leje dhe në vend të saj sot gjendet një ndërtesë e re e Post Telekomunikacionit të Kosovës. Ndërtesa e vjetër ka qenë shtëpia e Aleksandër Aca Maroviqit – njërit prej themeluesve të Partisë komuniste në Kosovë – dhe ka shërbyer si vend takim për komunistët e rrethit të Graçanicës (Prishtinës) qysh nga viti 1941.



Emin Gjiku (me vendim prej vitit 1955)

Kjo ndërtesë dikur ka qenë pronë e familjës së njohur Gjinolli. Prej vitit 1957 ky grup ndërtesash – duke përfshirë këtu shtëpinë e shërbëtorëve, shtëpinë e mysafirëve dhe shtëpinë e familjës – i takon Muzeut të Kosovës. Emin Gjinolli ka qenë i njohur me nofkën 'Emin Küçük – nga turqishtja 'Emini i vogël' – që më pas u shëndërrua në 'Emin Gjiku'. Në anën e majtë prej derës kryesore të oborrit, mund të shihet e vetmja ndërtesë që ka mbijetuar shkatërrimin e Çarshisë së vjetër. Është baktur këtu në vitin 1963. Gjatë viteve 1990-të, ky kompleks është përdorur si muze i natyrës. Në vitin 2003 renovimi i kompleksit ka filluar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtar për ta shëndërruar atë në muze etnologjik.



Shtëpia e Hynyerëve (me vendim prej vitit 1967)

Kjo shtëpi private – konak tipik osman – është nën mbrojtje që nga viti 1967. Familja që jeton aty është duke u munduar ta largojë pronën e tyre nga lista e monumenteve të mbrojtura.



Shtëpi private në rr. Tanashko Raiq 7 (sot rr. Gustav Mayer 7, me vendim prej vitit 1967)

Në këtë shtëpi është themeluar Partia komuniste e rinisë së rrethit të Graçanicës (Prishtinës) në vitin 1941. Ajo është vënë nën mbrojtje në vitin 1967 për ta përkujtuar rolin e kësaj Partie në lëvizjen nacional-çlirimtare të Prishtinës dhe rrethinës.



Biblioteka 'Hivzi Sylejmani' (me vendim prej vitit 1967)

Ndërtesa e bibliotekës së qytetit u ndërtua në vitin 1930. Ajo u bë e famshme nga Miladin Popoviqi – ish-udhëheqës i Komitetit regional të Partisë komuniste të Kosovës – që qëndroi këtu në vitin 1944. Nga viti 1948 kjo ndërtesë u shëndërrua në Bibliotekën e qytetit të Prishtinës.



Shtëpi qytetare në rr. M. Popoviq (sot rr. Nazim Gafurri dhe ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shencave të Kosovës, me vendim prej vitit 1955)

Kjo ndërtesë është një nga shtëpitë e vetme të mbetura të stilit të shtëpive qytetare të shekullit XIX. Pas Luftës së dytë botërore kjo shtëpi u nacionalizua dhe iu dha në shfrytëzim Sekretariatit për kulturë (homologut të Ministrisë së sotme të kulturës). Akademia e Arteve dhe Shkencave është e vendosur në këtë ndërtesë prej themelimit të saj, në vitin 1975.



Koleksioni i dorëshkrimeve të Bashkësisë Islame (me vendim prej vitit 1961)

Arkiva qendrore e Bashkësisë Islame u themelua në periudhën e vonë osmane si një arkiv krahinor për shënimet dhe veprimet e organizatave fetare si dhe për shënimet e shkollave islamike. Arkivit ia kanë vënë zjarrin policët serbë më 13 qershor të vitit 1999; pjesa më e madhe e koleksionit të shënimeve më se 300-vjeçare u zhduk në flakë. Vetëm një pjesë e vogël e dorëshkrimeve – e ruajtur në ndërtesën e Arkivit të Kosovës – ka shpëtuar.

Një tjetër e ardhme për të kaluarën?

Komunizmi ka qenë përgjegjës për zhvillimin e një programi të planifikuar të shkatërrimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Politika mospërfillëse e periudhës së Millosheviqit është pasuar, gjatë viteve 1998-1999, me një kampanjë të shkatërrimit fizik të monumenteve kulturore përgjatë tërë Kosovës. Në Prishtinë janë djegur xhami (Xhamia e Llapit) dhe ndërtesat (duke përfshirë këtu edhe Arkivin e Bashkësisë Islame).

Me 9 qershor 1999, autoritetet serbe zhvendosën gjithë arkivin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve në Beograd. Asgjë nga arkivi nuk është kthyer deri më sot. Gjithashtu, Muzeu i Kosovës është duke pritur kthimin e më shumë se 1.247 artefakteve arkeologjike dhe etnologjike, që janë dërguar në Beograd për ekspozitë.

Në vend së të ndryshohej ky trend negativ shumë-vjeçar, edhe me tepër shkatërrime janë bërë pas vitit 1999. Në gusht të vitit 2000, Asociacioni i arkitektëve të Kosovës ka botuar një letër publike që apelonte për veprim urgjent:

‘Si rezultat i shkatërrimit të pjesës historike të qytetit si dhe ndërtimit ilegal në të, objektet arkitektonike si dhe vlerat urbane që pasqyrojnë tërë trashëgiminë tonë kulturore janë duke u dëmtuar shumë keq.’

Duke filluar nga viti 2001, ekspertë kosovar dhe ndërkombëtar kanë propozuar shumë herë që të përpilohet një inventar i ri i trashëgimisë kulturore të Kosovës. Fonde të konsiderueshme janë shpenzuar në identifikimin e afër 3.000 monumenteve dhe vendeve historike, duke zhvilluar kështu një databazë dhe duke trajnuar punëtorë të institucioneve përgjegjëse. Përgaditja e inventarit të trashëgimisë kulturore ka qenë gjithashtu edhe njëra ndër ‘Standardet për Kosovën’ që është dashur të përmbushej. Mirëpo, deri më tani nuk ka ende inventar të botuar. Për më tepër, duket që asnjëra nga institucionet përgjegjëse nuk është duke përcjellur detajisht se çka është duke ndodhur me objektet e mbrojtura të trashëgimisë.

Në fakt neglizhenca dhe shkatërrimi kanë vazhduar. Nëse studiohet më hollësisht lista (edhe ashtu shumë e shkurtë) e 21 monumenteve të mbrojtura të qytetit të Prishtinës, pasqyra është edhe më e zyrtë: një ndërtesë nën mbrojtje është shkatërruar për ti lëshuar vend zyrave të reja të PTK-së (Rr. UÇK nr. 66); nga lista pararendëse e 76-të monumenteve të qytetit të Prishtinës, të përpiluar në vitin 2000, hulumtuesit e IKS-it kanë konstatuar se më se 19-të prej tyre janë zhdukur që nga viti 2001.

Duhet që urgjentisht të ndryshohet drejtimi i politikave shkatërruese të të gjashtë dekadave të kaluara. Çështja është urgjente për tri arsye kryesore:

1. Po që se shkatërrimi i trashëgimisë kulturore të Prishtinës nuk ndalet tani, shumë pak do të mbetet të ruhet për gjeneratat e ardhshme;
2. Po që se institucionet e Kosovës nuk mund të dëshmojnë tash se janë të aftë dhe se dëshirojnë ta zbatojnë ligjin që me dekada të tëra është në fuqi, atëherë çfarë dallimi do të sjellë një ligj më i mirë dhe i ri?
3. Nëse qeveria e Kosovës dhe shoqëria civile nuk mund të vërtetojnë se përkrahja e tyre e standardeve evropiane është e përcjellur me përkushtim[konkret për t’i zbatuar ato në praktikë, pozicioni i Kosovës në temën e trashëgimisë kulturore gjatë bisedimeve për status do të jetë i dobët.

Drejt epokës së re ...

Bazuar në hulumtimin tonë të vazhdueshëm, si dhe rekomandimeve të bëra nga ekspertë të shumtë vendor dhe të huaj të kësaj fushe, IKS dhe ESI rekomandojnë siç vijon:

1. **Kuvendit të Kosovës:** ta deklarojë përkrahjen e tij të plotë për standardet evropiane në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë, dhe zyrtarisht t'i përvetësojë ligjet e Këshillit të Evropës në këtë fushë;
2. **Kuvendit të Kosovës:** të bashkëpunojë me të gjitha institucionet përkatëse (Ministrinë e Kulturës, Institutin e Kosovës, Institutin e Prishtinës, Muzeun e Kosovës dhe të tjerë) për të përcaktuar qartë se çka duhet të bëhet për zbatimin efikas të standardeve evropiane.
3. **Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:** ta organizojnë një seminar të nivelit të lartë në Prishtinë, për ta theksuar rëndësinë e kësaj çështjeje për gjith Kosovën; të diskutojnë mundësi reale për të ecur më tutje në implementimin e Strategjisë Kombëtarë për Konservimin të Integruar; si dhe të ofrojnë përkrahje të fuqishme politike në zbatimin e ligjit nga të gjitha institucionet.
4. **Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve:** ta kompletojë dhe botojë inventarin ekzistues të monumenteve të mbrojtura; të inicojnë padi gjyqësore në të gjitha rastet kur ligji në fuqi shkelet; dhe të bashkëpunojnë ngushtë me komunën në sferën e planifikimit hapësinor në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje më efektive.
5. **Kombeve të Bashkuara:** t'i ofrojë mbështetje të plotë iniciativave Kosovare në këtë fushë, përfshirë nxjerrjen e ligjeve të reja dhe moderne; dhe të sigurojë se AKM-ja dhe strategjia e tyre e privatizimit po ashtu respekton standardet e Këshillit të Evropës si dhe strategjitë për mbrojtje të institucioneve gjegjëse Kosovare.
6. **Shoqërisë civile kosovare:** ta ngritë profilin e kësaj çështjeje dhe t'ia sqarojë publikut të gjerë rëndësinë ekonomike dhe sociale të mbrojtjes efektive të trashëgimisë kombëtare.
7. **Komunitetit ndërkombëtar:** t'i bëjë presion Beogradit për t'i kthyer arkivat e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve si hap fillestar në hapjen e bisedimeve për statusin në çështjen e trashëgimisë kulturore.

Për IKS dhe ESI

Për IKS-in

IKS-i është një institut hulumtues jo-përfitues, i themeluar në verën e vitit 2004 nga tri analiste kosovare. IKS-i ofron hulumtime inovative dhe relevante me qëllim të nisjes së debateve mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës. IKS-i aplikon metodologjinë e ESI-t të hulumtimeve empirike të politikave, nga një perspektivë Kosovare.

Puna e IKS-it përkrahet nga një Bord këshillues që përfshin analistë dhe praktikantë Kosovare dhe ndërkombëtarë. Për vitin 2006 IKS-i financohet nga Balkan Trust for Democracy, Rockefeller Brothers Foundation, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Swiss Agency for Development and Cooperation.

Në bashkëpunim me 'tiri' – *governance-access-learning-network* – rrjet i përbërë nga tetë organizata hulumtuese nga mbarë bota, IKS-i është duke kryer një hulumtim për korrupsionin gjatë fazës së rindërtimit të pasluftës. Në muajt vijues, IKS-i do t'i studiojë kushtet socio-ekonomike të serbëve të Kosovës, përfshirë këtu edhe Mitrovicën. Më shumë informata për IKS-in mund të gjeni në www.iksweb.org.

Për ESI-n

ESI-i është një institut hulumtues i pavarur me bazë në Berlin, me fokus në integrimet Evropiane dhe në ardhmërinë e Evropës juglindore në veçanti. Që nga krijimi i tij, në vitin 1999, ESI ka bërë publikime të hollësishme mbi zhvillimet në Bosnje-Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Bullgari, Turqi dhe për politikën e përgjithshme të BE-së ndaj këtij regjioni.

Që nga viti 2001, ESI ka publikuar një numër të raporteve për Kosovën. Këto raporte kanë trajtuar çështje të zhvillimit regional (Peja, Mitrovica, Kosova juglindore), politikën ndërkombëtare (*Dilema osmane*), çështjet e minoriteteve, të ardhmen e serbëve të Kosovës (*Njerëzit apo territori, Parimi i Llozanës*) si dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës (*Drejt një plani për zhvillimin e Kosovës*). ESI gjithashtu ka prodhuar filma dokumentarë. Të gjitha raportet janë në dispozicion në: www.esiweb.org.

ESI gjithashtu përkrah punën e organizatave hulumtuese të themeluara rishtas, përfshirë këtu IKS-in në Kosovë dhe CRPM-in në Shkup.

Për projektin hulumtues për Prishtinën

Gjatë muajve të kaluar, IKS-i dhe ESI kanë bërë hulumtime mbi çështjen socio-ekonomike të Prishtinës, duke punuar në bashkëpunim me Austrian Erste Bank Privatstiftung si pjesë më e gjerë e projektit *Ekonomia e re gjeografike e Ballkanit*. Gjatë kësaj pune, analistët e IKS-it dhe ESI-t kanë takuar përpilues të politikave publike, biznesmenë, studentë dhe zyrtarë komunal, me qëllim të zbulimit të trendeve zhvillimore dhe të studimit të hollësishëm të çështjeve të trashëgimisë kulturore, zhvillimit ekonomik dhe planifikimit urban të Prishtinës. Si rezultat i kësaj pune, një raport i plotë do të botohet në të ardhmen e afërt.